



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDE
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.1 datë 17/12/2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 TË BASHKISË LIBRAZHDE DHE PROGRAMIT PËRFUNDIMTAR BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028” .

Analiza ligjore: Projekt-vendimi është i mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”. Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” Udhëzimit plotësues nr.19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”.

Situata aktuale e funksionit Propozimi dhe miratimi i këtij vendimi është kërkesë e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe si e tillë ai vjen në kohën e duhur në zbatim të ligjit, Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

Situata financiare : Projekti prezanton përdorimin e fondeve të pa shpenzuara në vitin 2025 të cilat trashëgohen në vitin 2026.

Drejtoria / Sektori përgjegjës – Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Çeshtjeve Sociale .

Monitorimi dhe raportimi : Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Çeshtjeve Sociale monitoron dhe shpërndan fondet sipas nevojave të bashkisë.

Impakti social / grupet që preken: Miratimi i buxhetit të vitit ka ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale, zhvillimin ekonomik dhe barazinë sociale. Përmes buxhetit përcaktohen prioritetet e qeverisë dhe mënyra e shpërndarjes së burimeve publike.

A është objekt i konsultimit publik: Projekt-vendimi është objekt i konsultimit publik .

“ Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë ” , i mbledhur me datën 17/12/2025 shqyrtoi projekt vendimit “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të bashkisë librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesem 2026-2028”, relacionin dhe dokumentat shoqërues paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: **Miratimin e projektaktit**

Bashkëlidhur procesverbali i mbledhjes së Komisionit

Adriçim Doda Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Lenal Bahiti Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë 17/12/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.2 datë 7/12/2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit **“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE (TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE), NË BASHKINË LIBRAZHDI PËR VITIN 2026”**.

Analiza ligjore: Projekt-vendimi është i mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Udhëzimit të përbashkët i Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 8885, datë 07.11.2016 “Për kushtet kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik.

Situata aktuale e funksionit Propozimi dhe miratimi i këtij vendimi është kërkesë e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe si e tillë ai vjen në kohën e duhur në zbatim të ligjit. Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”. i ndryshuar

Situata financiare : Projekti prezanton bazën e taksueshme familjarë dhe bizneset për taksa dhe tarifave vendore.

Drejtoria / Sektori përgjegjës – Drejtoria e të Ardhurave Vendore

Monitorimi dhe raportimi : Drejtoria e të Ardhurave Vendore monitoron dhe mbledh të ardhurat e bashkisë.

Impakti social / grupet që preken: Paketa fiskale synon të ruajë një balancë ndërmjet përballueshmërisë së detyrimeve vendore për familjet dhe subjektet ekonomike dhe nevojës për financimin e shërbimeve bazë si pastrimi, ndriçimi publik, mirëmbajtja e infrastrukturës, shërbimet sociale dhe administrative.

A është objekt i konsultimit publik: Projekt-vendimi është objekt i konsultimit publik .

“ Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë ” , i mbledhur me datën 17 / 12//2025 shqyrtoi projekt vendimit **“Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore), në bashkinë librazhd për vitin 2026”**, relacionin dhe dokumentat shoqërues paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: **Miratimin e projektaktit**

Bashkëlidhur procesverbali i mbledhjes së Komisionit

Adricim Doda Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Lenel Bahiti Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 17 /12/ 2025